



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 30.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.04.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Besa Security SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objektit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore FSSH" me Nr. të Prok: 206-24-1874-2-2-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Besa Security SH.P.K. e dt. 29.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objektit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore FSSH" me Nr. të Prok: 206-24-1874-2-2-1 kundër Njoftimit mbi vendimin e AK te datës 23.04.2024 te publikuar ne platformën elektronike.
2. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK te datës 23.04.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Besa Security SH.P.K me datë 29.04.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objektit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore FSSH" me Nr. të Prok: 206-24-1874-2-2-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 30.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas Besa Security SH.P.K:

1. Neni 1 - Qëllimi
2. Neni 28 - Specifikimet Teknike
3. Neni 69 - Aftësia Teknike dhe Profesionale

Pretendimi ankimor

1. Analiza financiare

Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE të prezantojnë analizën financiare. Tek Aneksi 1 specifikimet teknike, është dhënë edhe formati i analizës financiare që duhet të plotësohet.

Ndërsa, KSF Major Security, si fillim nuk i ka paraqitur 3 analiza financiare siç ishte prezentuar lista për 3 ndërrime, në të cilën ndërrimi i parë është me 8 orë pune në ditë, ndërrimi i dytë me 6 orë pune dite dhe 2 orë pune nate, dhe ndërrimi i tretë me 2 orë pune dite dhe 6 orë pune nate.

Në analizën financiare kanë llogaritur kontributin shtesë 5% vetëm në pagë, nuk i kanë përfshirë edhe shpenzimet tjera siç janë ditët e festave dhe shtesat për orët e natës.

Përllogaritaj e pagës me 250.00 Euro Neto (bruto 271.00) për 176 orë pune në muaj i bie që për një orë pune të rregullt roja duhet të paguhet me 1.54€ për orë, shtesa për punë në orar të natës 0.46€ dhe shtesa për punë në ditë të festave zyrtare 0.77€ për një orë pune.

Pushimi vjetor përshkallëzohet me 13.33 orë pune për çdo muaj që i bie 20.53€, ndërsa KSF Major ka llogaritur gabimisht 22.12€ pushim vjetor në muaj me një diferencë prej 1.59€ për çdo punëtorë për çdo muaj.

Sipas ligjit në fuqi në një pikë ku shërbimi ofrohet 24/7 nuk mund të ketë tarifë shtesë për punë gjatë vikendit, pasi që ditë vikendi mund të jetë secila ditë kalendarike. KSF Major Security ka paraqitur për 3 punëtorë orë shtesë për një pagë 14.80€ që është e kundërligjshme.

I njëjti ka llogaritur 11 ditë festa zyrtare në vit që nuk është e saktë pasi që janë 11 festa zyrtare por janë 12 ditë pune apo 24 ditë për dy vite dhe jo 22 siç e kanë llogaritur në analizën e tyre.

Sipas DT, OE është dashur të paraqes tre çmime të ndryshme duke u mbështetur me ligjin e punës dhe nga analiza financiare, përveç shtimit të pagesës për orë në fundjavë dhe mosllogaritje të saktë për kontributin e dhënë, ka bërë shkelje edhe me orët shtesë për punë në fundjavë.

Andaj, duke pasur parasysh se neni 59.4 i LPP-së ndër të tjera thotë se:

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit..."

2. Referencat

E po ashtu, duke pasur parasysh se në dosjen e tenderit kërkohet që:

"Operatori Ekonomik duhet të ofroj katalog apo ofertë teknike duke përshkruar të gjitha specifikacionet teknike të cilat i ofron specifikacionet duhet të jenë të kjarta dhe të detajuara."

Ku sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, specifikohet se në rast të problemeve si në vijim:

Problemi: Mungon specifikacioni teknik...

Si të veprohet? Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Neni i LPP-së: 28

Për më shumë,

<p>Në Dosjen e Tenderit, tek kapaciteti teknik dhe profesional, ju si AK keni kërkuar dëshmi për realizim të kontratave të ngjashme (citim): Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontrate).</p>	<p>Dëshmia 1 Lista e projekteve të shërbimeve të ngjashme të realizuara, në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve (i) kur shërbimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve shërben kopja e certifikatës (certifikatave) ose referencë të rëndësishme të lëshuar ose të bashke nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur shërbimet janë kryer për një blerës</p>
---	--

	privat, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;
--	--

OE në fjalë e ka dorëzuar vetëm një dëshmi të një kontrate të realizuar, me vlerë 990€. Ndërsa, kontratat tjera janë në realizim e sipër. Tek interpretimi i KRPP i datës 22.11.2022, i paraqitur në foton në vijim, thuhet se kontratat e kërkuara duhet të jenë të realizuara – jo në realizim e sipër.

Andaj, si rrjedhojë e fakteve dhe argumenteve të mësipërme, kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues që të bëni anulimin e vendimit dhe të ktheni aktivitetin në rivlerësim.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore

Ne lidhje me dispozitën e shkelur për te cilat pretendon "**Besa security SH.P.K**", Autoriteti Kontraktues hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. Analiza Financiare

Neni 1 (Qëllimi) – sipas këtij neni AK është i obliguar që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Edhe pse nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozite, AK ju njofton se shpërblyer me kontrate operatorin ekonomik i cili ka ofruar ofertën e përgjegjshme me çmimin me te lire.

Ne lidhje me kërkesën AK ka përcaktuar:

Kërkesa 2: Operatori ekonomik me oferte duhet te prezantojë një analizë financiare për pagën bazë të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet te paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet te përfshijë se paku: Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për orët e natës, Festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensional, Fitimin e OE, TVSH-ne, Totali i ofertës. OE duhet te ketë kujdes ne kalkulimin e çmimeve për ore sepse çmimi për ore duhet te varioj varësisht nga ndërrimi i orarit te punës.

Dëshmia 2: Analiza financiare e hartuar nga OE.

Askund nuk është kërkuar që OE duhet te dorëzoj 3 analiza financiare por është thënë se OE duhet te ketë kujdes ne kalkulimin e çmimeve për ore sepse çmimi për ore duhet te varioj varësisht nga ndërrimi i orarit te punës. Si rrjedhoje OE ka dorëzuar Listën e çmimeve ku ne liste te çmimeve ka prezantuar cmimet e ndryshme për secilin ndërrim dhe ka marr parasysh ndërrimin me 8 orë pune në ditë, ndërrimi i dytë me 6 orë pune dite dhe 2 orë pune nate, dhe ndërrimi i tretë me 2 orë pune dite dhe 6 orë pune nate. Shih me poshtë.



TVSH	Çmimi për një m ² TVSH	Çmimi majtas për TVSH	Çmimi majtas në TVSH	Çmimi për 24 muaj
(a)	(b)	(c) = (a) x (b)	(d) = (c) x (1)	(d) / (2) x 24
18.00	1.89	366,18	432,00	10.568,00
12.00	2,17	441,38	520,80	12.499,20
18.00	3,00	612,17	720,00	17.280,00
				40.147,20

a 18%, Ndërsa në kolonën 1, duhet të plotësojë me



Gjithashtu MSh nuk ka dorëzuar një formular standard për plotësim por ne aneksin 1 ka paraqite vetem si shembull se si duhet te kalkulohet. Megjithatë MSh ka llogaritur analizat financiare ne baze te këtij shembulli dhe rezulton qe kompania ne fjalë plotëson kushtet sepse çmimi i ofruar mbulon te gjitha shpenzimet.

Ne lidhje me pretendimin tuaj "E po ashtu, duke pasur parasysh se në dosjen e tenderit kërkohet që: "Operatori Ekonomik duhet te ofroj katalog apo ofertë teknike duke përshkruar të gjitha specifikacionet teknike te cilat i ofron specifikacionet duhet të jenë të kjarta dhe të detajuara." Ndoshta keni gabuar por askund nuk është kërkuar katalogu, pra ne DT nuk figuron kjo kerkesa.

2. Referenca

Ne lidhje me pretendimit se "OE në fjalë e ka dorëzuar vetëm një dëshmi të një kontrate të realizuar, me vlerë 990€. Ndërsa, kontratat tjera janë në realizim e sipër. Tek interpretimi i KRPP i datës 22.11.2022, i paraqitur në foton në vijim, thuhet se kontratat e kërkuara duhet të jenë të realizuara – jo në realizim e sipër."

MSh hedh poshtë pretendimin tuaj sepse MSh ne Dosje te tenderit ka përcaktuar kërkesën për realizim te kontratave por nuk ka përcaktuar vlere. Kontrata e prezantuar ne listën e kontratave ne vlere prej 990 Euro plotëson kushtin sepse është përfunduar para publikimit te njoftimit për kontrate. Njoftimi për kontratë është publikuar me date **05.03.2024** ndërsa kontrata ne vlere prej 990 euro eshët përfunduar me **29.02.2024**:

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime te ngjashme ne tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate).

Dëshmia 1 Lista e projekteve të shërbimeve të ngjashme të realizuara, në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur, ku duhet saktësuat titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve (i) kur shërbimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve shërben kopja e certifikatës (certifikatave) ose referencë të rëndësishme të lëshuar ose të bashke nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur shërbimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;

**LISTA E KLIENTEVE-KONTRATAVE KRYESORE-SHERBIMET THEMELORE TE SIGURIMIT FIZIK
ROJE DHE SHUMAT**

Nr	Titulli kontrates	Vlera totale e kontrates	Data e nenshkrimit te kontrates dhe mbarimi	Emri klientit	Adresa	Numri i protokolit te kontrates
1.	Sigurimi fizik i objektit Q.E.A "Gulistan" ne Korishe	Per 12muaj, 13,302.72€	01.10.2023 30.09.2024	Q.E.A "GULISTAN" PRISHTINE	Fshati Banull-Lipjan Me NR biznesi:70468414	23/100104 ahmetg@gulistankosova.com
2.	Sigurimi i objektit te sherbimeve rezidenciale-Rishpallje	Per 12muaj 9,480.00€	07.12.2023 06.12.2024	K.K.-DECAN	Rr:Mentor Tolaj pn 51000 DECAN	Nr.prok:631-23-13192-2-3-6 prokurimi.decan@rks-gov.net
3.	Sigurimi Fizik I Objektit te KPMM-se	992.69€	31.01.2024 29.02.2024	Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale	Rr:Armend Daci Nr.1 10 000 Prishtine	318-24-528-2-4-7 www.kosovo-mining.org

TOTALI: 23,775.41€

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Berat Marmullaku**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**